



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

**AUTORITETI I KOMUNIKIMEVE ELEKTRONIKE DHE POSTARE
KËSHILLI DREJTUES**

V E N D I M

Nr.34, datë 15.05.2018

PËR

**“SHQYRTIMIN E ANKIMIT ADMINISTRATIV TË SIPËRMARRËSIT
ALBTELECOM SH.A PËR DISA NDRYSHIME DHE SHTESA NË VENDIMIN NR.19,
DATË 16.03.2018 TË KËSHILLIT DREJTUES TË AKEP”**

Këshilli Drejtues (KD) i Autoritetit të Komunikimeve Elektronike dhe Postare (AKEP), i përbërë nga:

1. Z. Ilir	Zela	Kryetar
2. Z. Alban	Karapici	Anëtar
3. Znj.Edlira	Dvorani	Anëtar
4. Znj.Ketrin	Topçiu	Anëtar
5. Znj.Klarina	Allushi	Anëtar

dhe sekretare Znj. M.Drushku, në mbledhjen e datës 15.05.2018, sipas procedurës së përcaktuar në ligjin nr. 9918 datë 19.05.2008 “Për Komunikimet Elektronike në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar, dhe Rregullores së Brendshme të Funkcionimit të Këshillit Drejtues të AKEP, miratuar me Vendimin Nr. 7, datë 16.02.2017 të Këshillit Drejtues të AKEP, shqyrtoi çështjen me objekt:

“Ankimi administrativ i sipërmarrësit Albtelecom sh.a për disa ndryshime dhe shtesa në Vendimin Nr.19, datë 16.03.2018 të Këshillit Drejtues të AKEP”

BAZA LIGJORE:

1. Neni 87 i Ligjit nr. 9918, datë 19.05.2008 “Për komunikimet elektronike në Republikën e Shqipërisë” i ndryshuar (**ligji nr. 9918**);
2. Pika 3 e nenit 113, nenet 135, 136, 139 dhe 140 i Ligjit nr. 44/2015 datë 30.04.2015 “Kodi i Procedurave Administrative i Republikës së Shqipërisë” (**ligji nr. 44/2015**);
3. Rregullore nr.43, datë 22.09.2016, “Për mënyrën e zbatimit të portabilitetit të numrit”, ndryshuar me VKD nr.19, datë 16.03.2018 (**Rregullore**);

4. Neni 8 i Rregullores së Brendshme “Për Funkcionimin e Këshillit Drejtues të Autoritetit të Komunikimeve Elektronike dhe Postare”, miratuar me Vendimin nr.7, datë 16.02.2017 të Këshillit Drejtues të AKEP (**Rregullore e Brendshme**).

K Ë S H I L L I D R E J T U E S :

Nga shqyrtimi i materialit shkresor të paraqitur nga Grupi i Punës, si më poshtë:

1. Ankim administrativ i sipërmarrësit Albtelecom sh.a, me shkresë me nr.3543 prot, datë 16.04.2018 (nr.1132 prot. i AKEP, datë 16.04.2018), me objekt “Ndryshimin e Vendimit të Këshillit Drejtues Nr.19, datë 16.03.2018 për miratimin e dokumentit “Miratimin e disa shtesave dhe ndryshimeve në Rregulloren Nr.43, datë 22.09.2016, “Për mënyrën e zbatimit të portabilitetit të numrit”, për ndryshimin e përmbajtjes së Rregullores bashkëlidhur këtij vendimi ne lidhje me nenin 16, pika 7, nenin 18, pika 6, nenin 20, pika 2 dhe korrigjimin e një gabimi material në nenin 18, pika 16”;
 2. Relacionin shpjegues mbi trajtimin e çështjes të paraqitur nga grupi i punës;
 3. Projekt – akti administrativ, miratues;
- si dhe:
- konsiderimi i shpjegimeve të dhëna nga relatori i çështjes dhe diskutimeve në mbledhje;
 - fakteve të paraqitura dhe analizës së tyre referuar bazës ligjore të sipërcituar;

V Ë R E N :

I. Në aspektin procedural:

1. Akti administrativ Nr.19, datë 16.03.2018 për “Miratimin e dokumentit “Miratimin e disa shtesave dhe ndryshimeve në Rregulloren Nr.43, datë 22.09.2016, “Për mënyrën e zbatimit të portabilitetit të numrit” është ankimuar nga sipërmarrësi Albtelecom Sh.a., bazuar në të drejtën dhe procedurën e përcaktuar në pikën 1 të nenit 130 të ligjit nr. 44/2015 dhe dispozitat vijuese të tij;
2. Përmbajtja e Ankimit administrativ është në përputhje me përcaktimet e parashikuara në nenin 131 të ligjit nr. 44/2015 dhe është depozituar brenda afatit ligjor të përcaktuar në pikën 1 të nenit 132 të këtij ligji, pranë organit administrativ të cilit i drejtohet ankimi sipas shkronjës a) të nenit 134/1 të ligjit nr. 44/2015;
3. Ankimi administrativ gjendet në kushtet e pranimit të ankimit sipas nenit 135 të ligjit nr. 44/2015;

II. Në aspektin e trajtimit në thelb të çështjes:

1. Ankimesi në ankimin administrativ parashtron kërkesën për ndryshimin e :

VKD Nr.19, datë 16.03.2018 për “Miratimin e dokumentit “Miratimin e disa shtesave dhe ndryshimeve në Rregulloren Nr.43, datë 22.09.2016, “Për mënyrën e zbatimit të portabilitetit të numrit”;

2. Pretendimet dhe kërkesat kryesore të ankimesit Albtelecom sh.a për ndryshimin e vendimit të cituar janë si më poshtë:

- Në lidhje me nenin 16, pika 7, Albtelecom kërkoi të shtohet pika 6/1 në draft rregullore si më poshtë vijon:

“Koha minimale e detyrueshme për pajtimtarin që të qëndrojë në operatorin në të cilin ka aktivizuar numrin për herë të parë, përpara së të vendosë një kërkesë për bartje është 3 muaj.”

Për sa më sipër, Albtelecom konsideron të padrejtë që për një kërkesë të argumentuar që vetëm përmirëson procesin e portabilitetit të numrit, që kufizon praktika abuzuese në treg, që kërkohet dhe pranohet edhe nga operatorët në treg dhe për më tepër kur pranohet edhe nga vetë AKEP në draftin e rishikuar pas këshillimit publik, të hiqet nga dokumenti përfundimtar pa asnjë shpjegim apo argumentim që ky cilësim do mund ta dëmtonte procesin e portabilitetit të numrit;

- Në lidhje me nenin 18, pika 6, për afatin e kthimit të përgjigjes të përdoruesve celularë me paspagim, kërkohet të reflektohet përcaktimi si më poshtë:

“ ...Për përdoruesit celularë me paspagim ky afat nuk do të jetë më i gjatë se 4 orë pune në 90% të rasteve të muajit kalendarik dhe jo më i gjatë se 1 (një) ditë pune të 100% të rasteve të muajit kalendarik...”;

- Në lidhje me nenin 20 “Rishikimi”, pika 2, mbi detrimin për bashkëpunimin e palëve, përcaktimi 2...operatorët duhet të gjejnë një zgjidhje brenda afateve të përcaktuara në këtë rregullore...”, është një ndryshim, që nuk është sugjeruar as në draftin e publikuar për këshillim publik nga AKEP dhe as në versionin e rishikuar të draft rregullores dhe referimi “brenda afateve të përcaktuara në këtë rregullore” është irrelevant, pasi nuk ka asnjë afat tjetër konkret të përcaktuar në rregullore që detyron operatorët të gjejnë një zgjidhje për vazhdimin e procesit të bartjes dhe propozojmë lënien në fuqi sipas formulimit në dokumentet e këshillimit publik dhe në dokumentin e rishikuar ku shprehet detyrimi i operatorëve për gjetjen e një zgjidhjeje brenda 8 orëve pune;

- Korrektim të një lapsusi në nenin 18, pika 16 nga ODH (operatori dhënës) në OM (operator marrës) pasi është ky i fundit që hedh kërkesën në sistem dhe jo operatori dhënës.

III. AKEP pasi e ka gjetur ligjërish të pranueshëm ankimin, lidhur me pretendimet dhe arsyetimin e ankimesit gjykon si më poshtë vijon:

1. Në lidhje me kërkesën për ndryshimin e afatit 3 mujor të së drejtës së portimit për aktivizimet e reja (neni 16, pika 7 e Rregullores), AKEP:

- Nuk pranon kërkesën e Albtelecom, pasi gjykon se janë vetë operatorët celularë që kanë krijuar një situatë të tillë (blerjen e një karte SIM të një operatori dhe më pas menjëherë kërkesë për port out tek një operator tjetër). Operatorët celularë kërkojnë që të rregullojnë një problem të marrëdhënieve të tyre me kontraktorët/nënkontraktorët nëpërmjet rregullores së miratuar nga AKEP dhe që synon së pari mbrojtjen e interesave të konsumatorit. AKEP gjykon se operatorët celularë kanë të gjitha mjetet/instrumentat e duhuara në dispozicion për të rregulluar këtë problem te brendshëm me pikat e shitjes së tyre.

Në pikën 9 të nenit 87 të ligjit nr. 9918 sanksionohet detyrimi për operatorët që afati i aktivizimit të numrit të bartur duhet të jetë brenda një dite pune. AKEP duke iu referuar zbatimit rigoroz të këtij përcaktimi ligjor ka kryer edhe ndryshimet përkatëse në rregullore.

Efektet e ardhura si rezultat i zbatimit të këtij detyrimi ligjor duhet të rregullohen nga operatorët në mënyrë të barabartë duke zbatuar rigorozisht edhe përcaktimet ligjore të parashikuara në nenin 99 të ligjit nr. 9918 lidhur me kontratën e pajtimit për ofrimin e shërbimeve publike të komunikimeve elektronike.

2. Në lidhje me kërkesën e Albtelecom për reflektim të afatit 4 orë pune për verifikim të detyrimeve të përdoruesve me paspagim edhe në pikën 6 të nenit 18, AKEP pranon ndryshimin e propozuar pasi është në linjë me përcaktimet e tjera të rregullores. Pra pika 6 e nenit 18 ndryshohet si më poshtë:

- “6. Të gjithë operatorët e rrjeteve dhe/ose shërbimeve të komunikimeve elektronike të lëvizshme do të aplikojnë procesin e plotë të automatizimit për të ekzaminuar dhe procesuar kërkesat për bartje dhe përgjigjet për to në rolin e Operatorit Dhënës. Për operatorët celularë Dhënës, koha mes marrjes së kërkesës për bartje dhe përgjigjes nëpërmjet sistemit të CRDB nuk do të jetë më e gjatë se 5 minuta të 100% të rasteve të muajit kalendarik për pajtimtarët me parapagim. Për përdoruesit celularë me paspagim ky afat nuk do të jetë më i gjatë se **4 orë pune** në 90% të rasteve të muajit kalendarik dhe jo më i gjatë se 1 (një) ditë pune të 100% të rasteve të muajit kalendarik”.

3. Në lidhje me kërkesën e Albtelecom për rivendosjen e afatit 8 orë pune në nenin 20, pika 2, AKEP pranon propozimin e Albtelecom por gjykon ta vendosë në fund të paragrafit, pasi rregullorja e ndryshuar përmban dhe afate të tjera si 4 orë pune për verifikim të detyrimeve kontraktore dhe 1 orë pune për konfirmim nga ODH në CRDB të kërkesës pas korrigjimit të të dhënve ID apo pagesës së detyrimeve nga pajtimatri, dhe afati 8 orë punë është për rastet e tjera të bashkëpunimit midis ODH dhe OM. Pika 2 e nenit 20 ndryshohet si më poshtë:

- “2. Nëse kërkesa për bartje nuk mund të zgjidhet nëpërmjet shkëmbimit të mesazheve standarde elektronike, personi i kontaktit i operatorit Marrës do të kontaktojë drejtpërdrejtë personin e kontaktit të operatorit Dhënës. Duke respektuar parimin "one-stop-shop" të bartjes së numrit, operatorët duhet të gjejnë një zgjidhje brenda afateve të përcaktuara në këtë rregullore, **por jo më shumë se 8 orë pune për rastet e tjera**, duke shkëmbyer dhe përditësuar të dhënat e sakta në interes të pajtimtarit dhe vazhdimin të procesit të bartjes.

4. Në lidhje me zëvendësimin e termit të përdorur ODH me OM në fjalinë e parë të pikës 16 të nenit 18, AKEP pranon të kryjë korrektimin pasi është lapsus.

P Ë R K Ë T O A R S Y E:

Në mbështetje të procedurës së përcaktuar në Ligjin nr.9918 datë 19.05.2008 “Për Komunikimet elektronike në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar, neni 114, neni 115, si dhe Ligjit nr. 44/2015, datë 30.04.2015 “Kodi i Procedurave Administrative i Republikës së Shqipërisë” (Ligji nr. 44/2015) neni 130 e në vijim,

V E N D O S:

1. Pranimin e pjesshëm të ankimimit administrativ të sipërmarrësit Albtelecom sh.a, me shkresë me nr.3543 prot, datë 16.04.2018 (nr.1132 prot. i AKEP, datë 16.04.2018);
2. Ndryshimin e përcaktimeve të dokumentit Rregullore Nr.43, datë 22.09.2016, “Për mënyrën e zbatimit të portabilitetit të numrit”, e ndryshuar me Vendimit të Këshillit Drejtues të AKEP Nr.19, datë 16.03.2018, si më poshtë:

- a) Pika 6 e nenit 18 ndryshohen si më poshtë:

*“6. Të gjithë operatorët e rrjeteve dhe/ose shërbimeve të komunikimeve elektronike të lëvizshme do të aplikojnë procesin e plotë të automatizimit për të ekzaminuar dhe procesuar kërkesat për bartje dhe përgjigjet për to në rolin e Operatorit Dhënës. Për operatorët celularë Dhënës, koha mes marrjes së kërkesës për bartje dhe përgjigjes nëpërmjet sistemit të CRDB nuk do të jetë më e gjatë se 5 minuta të 100% të rasteve të muajit kalendarik për pajtimtarët me parapagim. Për përdoruesit celularë me paspagim ky afat nuk do të jetë më i gjatë se **4 orë pune** në 90% të rasteve të muajit kalendarik dhe jo më i gjatë se 1 (një) ditë pune të 100% të rasteve të muajit kalendarik.”*

- b) Pika 2 e nenit 20 ndryshohet si më poshtë:

*“2. Nëse kërkesa për bartje nuk mund të zgjidhet nëpërmjet shkëmbimit të mesazheve standarde elektronike, personi i kontaktit i operatorit Marrës do të kontaktojë drejtpërdrejtë personin e kontaktit të operatorit Dhënës. Duke respektuar parimin "one-stop-shop" të bartjes së numrit , operatorët duhet të gjejnë një zgjidhje brenda afateve të përcaktuara në këtë rregullore, **por jo më shumë se 8 orë pune për rastet e tjera**, duke shkëmbyer dhe përditësuar të dhënat e sakta në interes të pajtimtarit dhe vazhdimin të procesit të bartjes.”*

- c) Pika 16 e nenit 18, korrigohej dhe ndryshohet si më poshtë:

*“16. Koha e aktivizimit të numrit të portuar nuk duhet të jetë më e gjatë se 24 orë nga koha e dërgimit në sistem të kërkesës nga **OM**. Përfundim nga ky afat përbejnë rastet kur kërkesa duhet të procesohet gjatë ditëve të pushimit zyrtar ose*

kur kërkesa refuzohet nga ODH për shkak të arsyeve të përcaktuara në këtë rregullore. Në këto raste koha llogaritet nga momenti i hedhjes në sistemin CRDB të kërkesës nga operatori marrës. Përjashtim nga afati 24 orë përbën dhe rasti kur pajtimtari ka shprehur vullnetin në formularin sipas Aneks1 për realizimin e portimit në një afat më të gjatë se 24 orë.

3. Të njoftohet sipërmarrësi Altelecom sh.a. për këtë Vendim;
4. Ky Vendim të publikohet në faqen e internetit të AKEP: www.akep.al.

Ky vendim hyn në fuqi në datën e miratimit të tij.

K R Y E T A R

Ilir ZELA

ANËTARË:

- 1. Alban KARAPICI**
- 2. Edlira DVORANI**
- 3. Ketrin TOPÇIU**
- 4. Klarina ALLUSHI**